



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 62 Datë 26.03.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“MALËSIA SOLAR 2” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK NË  
LAHË E POSHTME, SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU  
SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17 .06.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 2 ” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër

**Konstatohet se:**

- Me shkresën me nr. 1047/1 Prot, datë 06.03.2018, shoqëria “Malësia Solar 2“ sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.
- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3; (gërmat “a”, “c”, “d”); 4.4.4 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 gërma “c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit); pa plotësuar
- Nenin 9 pika 4.4.3 gërma “b” (një diagramë elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes); do të njoftohet subjekti që t'i plotësojë ato brenda afateve që përcakton *“Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiant fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2500 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.